



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Integrimit Evropian*

*Ministarstvo Evropske Integracije/ Ministry of European Integration*

---

**MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN** shpallë **KONKURS** për këtë vend të punës:

**Titulli i pozitës:** Zyrtar i Logjistikës  
**Numri i referencës:** 02/2016- DFSHP /MIE  
**Grada e vendit punës:** Niveli administrativ  
**Koeficienti:** 6

**Qëllimi vendit të punës:**

Pranimi, specifikimi i kërkesave, porositja e mallit, pranimi, regjistrimi, shpërndarja ngarkimi i zyrtarëve me mallra dhe pajisje të porositura, konfirmimi i faturave për pagese për mallratë e pranuar.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit të IT-së dhe Shërbimeve Logjistike, Zyrtari është përgjegjës të:

- Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e logjistikës;
- Ofron mbështetje teknike dhe operative për institucion për zbatimin e praktikave më të mira menaxhuese të logjistikës, sistemeve dhe procedurave;
- Vlerëson sistemet ekzistuese të operacioneve logjistike dhe rekomandon masa përmirësuese që duhet të ndërmerren;
- Procedon të gjitha kërkesat, faturat për mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjeve të teknologjisë informative shpenzimeve të telefonit, karburanteve dhe pajisjen me inventar;
- Sigurojë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e iniciativave dhe procedurave të reja që lidhen me logjistikën;
- Harton, zbaton dhe menaxhon kontratat për furnizime që ndërlidhen me logjistikën kur është e nevojshme;
- Koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me akomodimin brenda ndërtesës dhe regjistrimin e inventarit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi:

### **Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të njohur teknike ose administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Arsimim i bachelor, trajnim përkatës dhe së paku katër (4) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative;

### **INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Ministria e Integrimit Evropian ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional ne organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), Dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në receptionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Sheshi Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://mei-ks.net/>

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IX zyra nr. 909.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm..

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimi me shkrim dhe intervistimit me gojë.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

**Afati i konkurrimit është prej datës 07.07.2016 deri me datë 21.07.2016 deri në orën 16:00.**

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 27-006